



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI
RREGULLORE
PËR DELEGIMIN E FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË
FONDEVE TË PENSIONEVE

Miratuar me Vendim Bordi nr.1, datë 13.01.2011

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë llojet e funksioneve, rregullat dhe procedurat për delegim të funksioneve nga shoqëria administrative të palët e treta.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të dispozitave të nenit 41, paragrafi 3 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Mbi fondet e pensionit vullnetar”, këtu e më poshtë (“*Ligji*”).

Neni 3
Delegimi i funksioneve

1. Shoqëria administrative, me përjashtim të administrimit të fondeve, mund të delegojë tek palë të treta, funksionet e mëposhtme të veprimtarisë së administrimit:
 - a) shërbime ligjore të veprimtarisë së administrimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) mbajtjen e kontabilitetit të veprimtarisë së administrimit;
 - c) kryerjen e publikimeve dhe raportimeve tek aksionerët e shoqërisë administrative dhe tek anëtarët e fondit;
 - ç) shërbimin e kryerjes së pagesave për anëtarët e fondit të pensionit;
 - d) mbajtjen e arkivës;
 - e) shërbimet e marketingut;
 - ë) shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; si dhe
 - dh) funksione të tjera të kësaj natyre.

2. Shoqëria administruese, mund të delegojë tek palët e treta shërbimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, vetëm me qëllimin e rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së kryerjes së këtyre funksioneve.
3. Delegimi i funksioneve të shoqërisë administruese tek palë të treta bëhet vetëm pas miratimit me shkrim nga Autoriteti.

Neni 5

Miratimi nga Autoriteti

1. Shoqëria administruese së bashku me kërkesën depoziton në Autoritet gjithë informacionin e mëposhtëm për palën e tretë ku kërkohet të delegohet funksioni:
 - a) emri dhe vërtetimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - b) adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e emailit;
 - c) emri, mbiemri dhe detaje të kontaktimit të personit të autorizuar për përfaqësim;
 - ç) të dhëna për reputacionin;
 - d) kontrata të ngjashme;
 - dh) eksperiencë të mëparshme të veprimtarisë;
 - e) të dhëna mbi ekspertin kontabël të autorizuar;
 - ë) projektkontratën e delegimit të funksioneve dhe kryerjes së detyrave nga pala e tretë në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese.
2. Përveç informacionit të paragrafit 1 më sipër, Autoriteti ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë mbi palën e tretë, në lidhje me kryerjen e funksionit që kërkohet t'i delegohet asaj.

Neni 6

Procedurat dhe afatet e shqyrtimit të kërkesës

1. Autoriteti miraton ose refuzon delegimin e funksionit, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria administruese, pasi bindet ose jo për përshtatshmërinë e delegimit të funksioneve tek pala e tretë.
2. Miratimi ose refuzimi i delegimit të funksionit tek pala e tretë bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të informacionit të fundit të kërkuar nga Autoriteti. Në rast refuzimi, Autoriteti i bën të ditur shoqërisë administruese edhe arsyet e këtij vendimi.

Neni 7

Përgjegjësia e shoqërisë administruese

1. Funksionet e deleguara kryhen nga pala e tretë në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese.
2. Pala e tretë duhet t'i ushtrojë vetë funksionet që i janë deleguar nga shoqëria administruese dhe nuk ka të drejtë t'i delegojë ato te palët e tjera.
3. Shoqëria administruese mban përgjegjësi të plotë për kryerjen e çdo funksioni të deleguar te palët e treta.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI